



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.3/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Ragip Namani dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike të dënuarit Xhevad Daciq nga P., sipas kërkesës për lirim me kusht, duke vendosur sipas ankesës së dënuarit, të paraqitur kundër vendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.714/24, të datës 23.12.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejuar ankesa e të dënuarit Xhevad Daciq nga P., në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë, e paraqitur kundër aktvendimit të Panelit për lirim me kusht, PLK.D.nr.714/24, të datës 23.12.2024.

A r s y e t i m

Paneli për Lirim me Kusht me aktvendimin PLK.D.nr.714/24, të datës 23.12.2024, në pikën e parë të dispozitivit ka refuzuar kërkesën për lirim me kusht e të dënuarit Xhevad Daciq nga i ati I., dhe e ëma N., e gjinisë Z., i lindur me datë, në R., me vendbanim në rr. "K. e B.", p.nr., P., me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Në pikën e dytë të dispozitivit është vendosur që kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 8 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Kundër këtij vendimi i dënuari përmes të autorizuarës së tij ka parashtruar ankesë, duke shprehur pakënaqësi për refuzim të kërkesës dhe duke pretenduar se vendimi i panelit është marrë si rezultat i gabimit faktik të qartë apo të dukshëm i cili ka ndikuar në të drejtat substanciale të dënuarit dhe seriozisht ka ndikuar në paanësinë dhe integritetin e procedurës, pasi që arsyetimi i aktvendimit të atakuar është në kundërshtim me gjendjen faktike, si dhe me vet vlerësimin e Ekipit Profesionist të Qendrës Korrektuese dhe me programin e trajtimit dhe rehabilitimit të dënuarit, me pretendim se i dënuari ka pasur sjellje të mira dhe korrekte gjatë qëndrimit në vuajtje të dënimit dhe se të njëjtit nuk i është shqiptuar asnjëherë ndonjë masë disiplinore apo ndonjë masë tjetër, andaj propozon që aktvendimi i atakuar i panelit të ndryshohet, ashtu që kërkesa e tij për lirim me kusht të aprovohet si e bazuar.

Me përgjigje në ankesë, Paneli për Lirim me Kusht e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e paraqitur nga i dënuari Xhevad Daciq, me propozim që e njëjta ankesë të hedhet poshtë si e palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës në mbështetje të nenit 117 paragrafi 11 dhe 12 dhe 16 të Ligjit Nr. 08/L-132, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, gjeti se:

Ankesa është e palejuar.

I dënuari Xhevad Daciq, përmes Institucionit të Qendrës Korrektuese ku është në vuajtje të dënimit me burg, më datë 10.12.2024 ka parashtruar kërkesë për lirim me kusht, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Nr.08/L-132. Paneli për Lirim me Kusht me aktvendimin PLK.D.nr.714/24 të datës 23.12.2024, ka trajtuar kërkesën e të dënuarit dhe të njëjtën e ka refuzuar, ndërsa në këshillën juridike e ka njoftuar palën se ankesa kundër këtij vendimi nuk është e lejuar. Përkundër kësaj pala ka paraqitur ankesë kundër vendimit me të cilin i është refuzuar kërkesa për lirim me kusht.

Për ta trajtuar këtë çështje Gjykata Supreme i është referuar dispozitës së nenit 117, paragrafi 16 të Ligjit (Nr.08/L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, me të cilën është përcaktuar se: *“Dispozitat e këtij neni nuk vlejnë për rastet kur Paneli për lirim me kusht e shtynë rastin për rishqyrtim nga gjashtë (6) muaj e tutje”*. Në këtë rast Paneli për lirim me kusht të dënuarit ja ka refuzuar kërkesën për lirim me kusht dhe njëherit në vendim ka konstatuar se refuzimi ka të bëjë me periudhën prej 8 muajve dhe se e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati. Mbi këtë bazë Gjykata Supreme ka gjetur se ankesa e paraqitur nga i dënuari Xhevad Daciq, duhet të hedhet poshtë si e palejuar, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për arsyet e paraqitura më lart, në bazë të nenit 117 paragrafi 11, 12 dhe nenit 16 të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.3/2025, datë 13.02.2025

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

Lumni Sallauka